



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Kryesuesi i Kuvendit

Nr. 001/16

Datë: 30.04.2010

Në bazë të Nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, (**Ligji Nr. 2003/14**); Neneve 12.2 /d/ dhe 17 /b/ të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (**Ligji Nr. 03/L-040**); **nenit 10** shkronjat **b**), dhe **nenit 20.1** shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Junikut Nr. 001/696 të datës 27.11.2008, Kuvendi i Komunës së Junikut në Mbledhjen e rregullt të mbajtur më 30.04.2010, merr:

V E N D I M
PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR URBAN
“ZONA INDUSTRIALE”

Neni 1

Me këtë Vendim fillohet Hartimi i **Planit Zhvillimor Urban “Zona Industriale”**, /në tekstin e mëtejme : **Plani**/.

Neni 2

Me këtë **Vendim** përfshihet Lokacioni **“Mali i Junikut”** me sipërfaqe prej **S=505100 m²** respektivisht, Ngastrat Kadastrale me nr: **4166, 4167/1, 4167/2, 4167/3, 4167/4, 4167/5, 4167/6, 4167/7, 4167/8, 4169, 5133 dhe 5127**; Zona Kadastrale Junik.

Neni 3

Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij Plani, sipas këtij Vendimi, është promovimi i zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, harmonizimi i drejtpeshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura, mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të regjimit të planifikimit hapësinor dhe urban në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe arritjen e caceve afatgjata të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Komunës së Junikut.

Neni 4

Ky **Plan** është pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Komunal dhe duhet të jetë bazë për hartimin e Planeve Rregulluese Urbane.

Neni 5

Bartës i hartimit të Planit nga neni 1 i këtij Vendimi është Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.

Neni 6

Bartësi i hartimit të Planit sipas Nenit 1 të këtij Vendimi është i obliguar që Planin ta hartojë në afat kohor prej tre /3/ muajve.

Neni 7

Projekt Plani duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e Planit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në mjetet e informimit.

Neni 8

Mjetet Financiare për Hartimin e Planit sigurohen nga Investuesit Privat.

Neni 9

Plani hartohet për periudhën kohore më së paku pesë / 5 / vjeçare.

Neni 10

Elaborati i Planit sipas Nenit 1 të këtij Vendimi duhet të hartohet në tri /3/ kopje (të origjinalit) fizike dhe /1/ elektronike.

Neni 11

Ky **Vendim** hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesuesi i Kuvendit
Sinan Gacaferi
